



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

VENDIM

NR. 57, DATË 05.08.2020

MBI

**NDRYSHIMIN E TË DHËNAVE TË PARAQITURA NË KËRKESËN PËR
MARRJEN E AUTORIZIMIT NGA SHOQËRIA “PREMIUM MEDIA” SH.P.K.,
PËR OFRIMIN E SHËRBIMIT TË PROGRAMIT AUDIOVIZIV ONLINE NGA
“PREMIUM CHANNEL” NË “PREMIUM TRAVEL”**

Autoriteti i Mediave Audiovizive, i përbërë nga:

Gentian	Sala	Kryetar
Sami	Nezaj	Zëvendëskryetar
Agron	Gjekmarkaj	Anëtar
Gledis	Gjipali	Anëtar
Suela	Musta	Anëtar

mori në shqyrtim çështjen që i përket palëve:

Kërkues: Shoqëria “Premium Media” sh.p.k.

Objekt: Mbi ndryshimin e emrit të shërbimit të programit audioviziv online nga “Premium Channel” në “Premium Travel”.

Baza Ligjore: Neni 19, pika 16, i ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

VËREN SE:

Subjekti person fizik Gentian Ferhati është autorizuar nga Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) me shkresën nr. 139 prot., datë 14.01.2014, për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv online “Tv Wedding Channel”. AMA me vendimin nr. 19, datë 31.01.2018, ka miratuar kalimin e të drejtave të autorizimit për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv online “Tv Wedding Channel” nga personi fizik Gentian Ferhati te shoqëria “Gentian Ferhati” sh.p.k. AMA me vendimin nr. 127, datë 08.06.2018, ka miratuar ndryshimet e ndodhura në strukturën e pronësisë dhe ndryshimin e emrit të shoqërisë nga “Gentian Ferhati” sh.p.k., në “Premium Media” sh.p.k. AMA me vendimin nr. 26, datë 15.02.2019, ka rinovuar autorizimin e shoqërisë “Premium Media” sh.p.k., për ofrimin e shërbimit të programit

audioviziv online "Premium Channel". AMA me vendimin 165, datë 07.11.2019, ka miratuar kalimin e të drejtave të licencës së shoqërisë "Radio Travel" sh.p.k., për subjektin audio privat "Radio Travel", tek shoqëria "Premium Media" sh.p.k. Afati i vlefshmërisë së autorizimit përfundon në datën 07.12.2023.

Shoqëria "Premium Media" sh.p.k., me shkresën, administruar në AMA, me nr. 3549 prot., datë 07.10.2019 ka njoftuar lidhur me ndryshimin e emrit të shërbimit të programit audioviziv online nga "Premium Channel" në "Premium Travel".

Në vijim, AMA me shkresën nr. 3549/1 prot., datë 21.10.2019, ka kërkuar nga subjekti depozitimin e Certifikatës së Regjistrimit të logos apo markës, të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI), lidhur me përdorimin e emrit "Premium Travel".

Shoqëria "Premium Media" sh.p.k., me shkresën nr. 3549/2 prot., datë 26.12.2019, ka depozituar pranë AMA-s, fotokopje të formularit të aplikimit nr. AL/T/2019/001085, për regjistrimin e markës "Premium Travel", duke njoftuar se: *"Në përgjigje të shkresës tuaj me nr. prot. 3549/1, dëshirojmë t'ju bëjmë me dije se kompania ka filluar procedurat e regjistrimit të markës "Premium Travel" dhe ka përfunduar aplikimin pranë institucionit përkatës me numër aplikimi AL/T/2019/001085. Siç jeni në dijeni procedura e lëshimit të certifikatës kërkon një kohë të gjatë, ndaj për të qenë korrekt me kërkesën tuaj po i bashkëlidhim kësaj shkrese një kopje të aplikimit. Certifikata e Regjistrimit të Markës dhe Logos do ju dërgohet menjëherë në momentin e lëshimit nga autoritetet përkatëse."*

Më tej AMA me shkresën nr. 126 prot., datë 15.01.2020, ka njoftuar shoqërinë "Premium Media" sh.p.k., se duhet të depozitojë kopjen e njëzuar me origjinalin të Certifikatës së Regjistrimit të logos apo markës, të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI), lidhur me përdorimin e emrit "Premium Travel", në mënyrë që të procedohet me ndryshimin e emrit të subjektit audioviziv online nga "Premium Channel" në "Premium Travel".

Me shkresën nr. 126/1 protokollin ynë, datë 15.07.2020, subjekti ka depozituar Certifikatën e Regjistrimit të markës, të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI), lidhur me përdorimin e emrit "Premium Travel", për një periudhë 10 vjeçare me numër regjistrimi 20781.

Në mbështetje të parashikimeve të ligjit nr. 97/2013, i ndryshuar, subjektet kanë detyrimin ligjor të njoftojnë për ndryshimet e ndodhura në të dhënat e paraqitura në kërkesën për licencë/autorizim, brenda afatit prej 30 ditësh nga data e kryerjes së ndryshimeve.

Sa më sipër, AMA e gjen të drejtë e të mbështetur kërkesën e shoqërisë "Premium Media" sh.p.k.

PËR KËTO ARSYE,

Autoriteti i Mediave Audiovizive, në mbështetje të nenit 19, pika 16 të ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës së shoqërisë “Premium Media” sh.p.k., duke ndryshuar emrin e shërbimit të programit audioviziv online nga “Premium Channel” në “Premium Travel”.
2. Ngarkohet administrata e AMA-s për kryerjen e veprimeve të mëtejshme në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar:

Gentian SALA

Zëvendëskryetar:

Sami NEZAJ

Anëtarë:

Agron GJEKMARKAJ

Gledis GJIPALI

Suela MUSTA